Cyber security is an ambiguous topic. Company and citizens should protect themselves from cyber attack, but their communication should not be encrypted, as the government cannot monitor terrorist activities. Security comes at a price, but it is not always sure that an individual, a company is fully protected. Another paradox is that while studying user's data can improve the quality of life, this can also lead to violation of privacy. (Bruijn & Janssen, 2017)

6.1.2 The human vulnerability in the action against cybercrime

The technological equipments are enough to keep systems secure, but the user compromise the security with his behaviour.

Maintaining and updating systems are necessary to ensure they have the proper defence against attacks. Humans must play their role in acting according to the secure policies, as unawareness can lead to failed practices like weak password, visiting dangerous websites, installing uncertified software. (Bruijn & Janssen, 2017)

6.1.3 Uncertainty in cyber security

The hacker's target of attack is unknown, so this can lead to think that maybe I will not be the target of the hacker. Thinking this way can lead to take no appropriate measure to secure the system. Though an individual, a company etc take precautions, there is always the potential to suffer a cyber attack. (Bruijn & Janssen, 2017)

6.2 Expressing convincingly the policies

Because of the above reasons, expressing the necessary policies to fight cy-

bercrime can be difficult. What is necessary to achieve this is communicating a message based on facts. It is important also, that the solution of dealing with cyber attacks is understood and cannot be easily challenged. While communicating the strategy, the complexities should be reduced in order that the message is clear and easy to understand.

The conclusion is: policies should be based on facts and the message should be clear on what should be the right measures of being secure. (Bruijn & Janssen, 2017)

6.3 Cyber security awareness policies characteristics

The cyber security awareness policies, in order to have success in the battle against cybercrime, should be:

- Interesting, being easy to learn
- Appropriate to the sex, age, type of profession. For example a 30 years old person can learn differently from a 55 years old person.
- Non-technocratic to be understood by the wide mass of people who are not necessary IT professionals.
- On going, because the threats are constantly present.
- Doable in order to believe the way of defending the information assets.
- Oriented toward what should be done, rather than what should not be done.
- Providing feedback from users to help them create better methods to work safely on their computers. (Ki-Aries & Faily, 2017)

7. Conclusions

The development of technology has brought many benefits such as social networks, online banking, cloud computing etc, but with the development of technology, the methods of cybercriminal are sophisticated and can bypass even the well-controlled systems.

There are different reasons why somebody becomes a hacker, some of which are: psychological needs, financial needs, espionage etc. The society of a country plays his part in glorifying the hacker's achievement, when in fact the actions of a hacker have negative consequences.

In fact, less than 50% of reasons of data compromising are due to hacker's intention. The two other reasons are system vulnerability and human error.

Individuals can bypass system security because:

- They can be extroverted and this type of personality act in a carefree way.
- They can have clinical conditions such as ADHD (Attention deficit hyperactivity disorder), or impulsive control disorders.
- They are affected by internet addiction.
- They are provoked by the attacker through social engineering

Target of attack are individuals, businesses and government as well.

Facing the threat needs raising cyber security awareness in society. This is a complex activity because it needs the right way of expressing the policies against cybercrime.

The citizens, businesses, government institutions are part of a country. For the safety of a country it is important that all play their part, in the particular care that should be dedicated to information security. So, when all take care of security, we can say we have a consolidated state in the field of information security.

References

- Arora, B. (2016). *Exploring and analyzing Internet crimes and their behaviours. Perspectives in Science* 8, 540 – 542.
- Árpád, I. (2013). *A greater involvement of education in fight against cybercrime. Procedia - Social and Behavioral Sciences* 83, 371 – 377.
- Bendovschi, A. (2015). *Cyber-attacks – Trends, patterns and security countermeasures. Procedia Economics and Finance* 28, 24 – 31.
- Bruijn, H. d., & Janssen, M. (2017). *Building cybersecurity awareness: The need for evidence-based framing strategies. Government Information Quarterly* 34, 1 – 7.
- Hadlington, L. (2017). *Human factors in cybersecurity; examining the link between Internet addiction, impulsivity, attitudes towards cybersecurity, and risky cybersecurity behaviours. Heliyon* 3, e00346.
- Ki-Aries, D., & Faily, S. (2017). *Persona-centred information security awareness. Computers & Security* 70, 663 – 674.
- Pawar, M. V., & J, A. (2015). *Network security and types of attacks in network. Procedia Computer Science* 48, 503 – 506.

HUMAN RIGHTS IN THE EUROPEAN UNION REVIEW

Ph.D candidate Lindita Liçaj	Msc Anila Fega	Ph.D Jeta Goxha
University Collage “Pavarësia Vlorë” Faculty of Law and Political Science	University Collage “Pavarësia Vlorë” Faculty of Law and Political Science	University Collage Pavarësia Vlorë Faculty of Law and Political Science
<i>VLORE</i>	<i>VLORE</i>	<i>VLORE</i>
<i>lindita.licaj@ unipavaresia.edu.al</i>	<i>anila.fega@ unipavaresia.edu.al</i>	<i>jeta.goxha@ unipavaresia.edu.al</i>

Abstract

Human rights are at the focus of the development of every state and international organization, today when the attention of all them is directed towards the protection and the guarantee of human rights. The universality of human rights has created a mandatory normative corpus for all member states of international organizations. The European Union as an international organization has developed its policies for the protection and promotion of human rights, democracy and the rule of law. Despite the fact that the European Union was founded in its own way as the European Community for economic reasons, without specifying anything about human rights, the EU's further treaties established the importance of respecting and protecting the human rights of the Member States of the European Union.

This article intends to present the legal framework of the European Union for the protection and guarantee of human rights. The qualitative method is accomplished by exploring, describing and evidencing the acts of the EU Asquis and the human rights protection instrument in the European Union.

The EU Treaty defined that the EU is created by respecting human rights, including human dignity, freedom, democracy, equality and the rule of law. The Charter of Fundamental Rights was adopted by the EU with a declarative character defining all the personal, civic, political, economic and social rights enjoyed

by all people living in the EU in 2000. The Treaty of Lisbon (2009) has give the importance to the Charter, so the Charter acquired the same legal value as the Treaties. Since then all EU law must be compatible with the Treaties and the Charter. The signing of the European Convention on Human Rights by the European Union showed another dignified commitment to the protection and respect of human rights. The bodies of the European Union and the European Court of Human Rights have shown as well as the readiness and commitment received from the EU and the Member States for the guarantee, protection and respect of human rights.

Keywords: human rights, European Union, EU bodies, European Convention on Human Rights

DISIDENCA POLITIKE DHE ZHVILLIMI I DEMOKRACISË PJESËMARRËSE

“Cili vend mund të ruajë liritë e veta nëse udhëheqësve të tyre nuk u tërhiqet vëmendja, herë pas here, se njerëzit e tyre e ruajnë shpirtin e rezistencës?”

President Thomas Jefferson

Dr. Ervin MUÇO

*Kolegji Universitare Pavarësia Vlorë
ervin.muco@unipavaresia.edu.al*

Abstrakt

Lufta për të fituar dhe mbrojtur lirinë përfaqëson një vlerë të pandashme të natyrës njerëzore. Aq e ngulitur është kjo vlerë sa edhe në sistemet më të egra e diktatoriale theksohet se qëllimi i tyre është zhvillimi dhe garantimi i lirisë. Liria është kryefjala e çdo diskursi politik.

Gjithësesi, shoqëria njerëzore karakterizohet nga një përplasje e vazhdueshme midis fjalës së lirë dhe censures, manipulimit, shtypjes apo skllavërimit të një shoqërie. Në këtë kontekst ne do t'i referohemi këtij procesi si disidencë. Disidenca është një formë apo përpjekje për arritjen e lirisë. Ajo synon të luftojë politikën dhe praktikën e mbrapshta shtetërore. Disidentët vejnë në diskutim pushtetin simbolik të aktorëve shtetërore dhe që mbështetet nga media, bota akademike dhe nga pjesa më e madhe e popullsisë. Në mbarë botën disidentët janë të angazhuar në arritjen e barazisë gjinore, luftën kundër varfërisë, lirisë së shtypit e zbatimit të ligjit.

Për shkak të natyrës së saj, disidenca dhe disidentët janë nën presionin e vazhdueshëm të shtetit. Ata janë etiketuar me nofka të ndryshme si rebelë, armiq të popullit, të çmendur, heretikë etj. Disidentët janë nën efektin e mbikqyrjes, rrëmbimit, kqtrajtimit, vrasjes, arrestimit dhe torturës. Këto qëndrime të shtetit sjellin dëmtimin e demokracisë duke e kufizuar aftësinë e individëve dhe shoqërisë për të identifikuar dhe adresuar politikën dhe praktikën që ata i konsiderojnë si të papranueshme.

Kultivimi dhe edukimi i disidencës përbën një mekanizëm efektiv për garantimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë. Vetëm nëpërmjet disidencës shoqëria jonë do të jetë në gjendje të luftojë dhe parandalojë politikën dhe praktikën që dëmtojnë dhe pengojnë zhvillimin e shoqërisë.

Përsa kohë shoqëria njerëzore nuk do të jetë e aftë të kultivojë një mjedis “të vërtetë” demokratik ku liritë dhe të drejtat e individëve respektohen, pikëpamjet ekstreme në spektrin ideologjik do të gjejnë një tokë gjithnjë e më fertile për tu zhvilluar. Partitë politike duket se luajnë një rol kyç në procesin e zhvillimit, ruajtjes dhe funksionimit të demokracisë por, fatkeqësisht, ndikimi i tyre, shpesh, e mbyl shkëmbimin e ideve, zhvillimin e mekanizmave të kontrollit të nevojshëm për (para)ndalimin e abuzimit me pushtetin dhe përmirësimin e cilësisë së politikave qeveritare. Hapësira politike rrëmbehet, shpesh, nga partitë politike kryesore të cilat lejojnë pak hapësirë për eksperimentimin e ideve të reja.

Nga ana tjetër, zhvillimi i komunikimit politik nëpërmjet rrjeteve sociale ka bërë që politikat të artikulojnë në mesazhe me 140 karaktere në Twitter apo Facebook. Një komunikim i tillë ka arritur sukses në zgjerimin e audiencës të synuar, por, njëkohësisht, ka ngushtuar kapjen e mesazhit të vërtetë që synohet të dërgohet. Realiteti i sotëm politik i jep më shumë përparësi formës se sa përmbajtjes, duke e lënë sistemin tonë të qeverisjes më të dobët dhe të paafte për të menduar dhe planifikuar të ardhmen. Në këtë situatë demokracia e një vendi vihet në rrezik dhe politika nuk është më në gjendje që të arrijë dhe ruajë drejtësinë sociale.

Për të shpëtuar demokracinë e një vendi, nga një situatë e tillë, është e rëndësishme që shoqëria të zhvillojë pjesëmarrjen demokratike. Krahasuar me demokracinë përfaqësuese, pjesëmarrja demokratike synon të advokojë më shumë forma të pjesëmarrjes qytetare në jetën politike të një vendi. Një nga format se si shoqëria mund të angazhohet në pjesëmarrjen demokratike është nëpërmjet disidencës, e cila shërben si një forcë monitoruese brenda organizatave. Ajo është një shenjë paralajmëruese për pakënaqësitë që shfaqen nga politikat dhe praktikrat e një qeverie.

DISA KUPTIME MBI DISIDENCËN

Koncepti i disidencës rrjedh nga latinishtja *dissentire* dhe nënkupton mospajtimin me opinionet, besimet fetare apo politikat dhe praktikrat qeveritare. Gjithësesi, **disidencë mbart një larmi kuptimesh: ajo mund të përkufizohet si mungesë vullneti për të bashkëpunuar me të gjitha burimet e autoritetit, të cilat mund të jenë sociale, kulturore, apo qeveritare.** Një tjetër qasje e shpreh disidencën si shprehje të opinionëve të ndryshme nga ato të pranuar zyrtarisht. Gjithashtu, ajo mbart kuptimin e mospajtimit me filozofinë, metodat, qëllimet e një partie politike apo qeverie. Mospajtimin apo kundërshtimin e doktrinës apo autoritetit të një force politike apo grupimi fetar.

Në teorinë politike, disidenca është studiuar, kryesisht, në marrëdhënie me pushtetin qeveritar. Disidenca politike i referohet çdo forme të shprehjes që ka për qëllim të përcjellë pakënaqësinë ose mospajtimin me politikat e një qeverie. Kjo shprehje mund të marrë trajta të ndryshme nga demonstratat paqësore, ngritja e zërit nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj elektronike e deri te përdorimi i dhunës. Gjithashtu, disidenca është e lidhur ngushtë me dy koncepte, mendimin kritik dhe tolerancën. Të dyja këto koncepte janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe shërbejnë për të vënë në diskutim legjitimitetin politik dhe sjelljen e një qeverie në raport me shtetasit e vet.

Disidenca është e lidhur me mendimin kritik duke mundësuar menduarit dhe vënien në diskutim të nocioneve, autoritetit, “të vërtetave” dhe kuptimeve të pranuar. Mendimi kritik është një mënyrë e të menduarit –rreth një subjekti, përmbajtjeje apo problemi- në të cilën personi që mendon përmirëson cilësinë e të menduarit duke analizuar, vlerësuar dhe rikonstruktuar (rreth subjektit, përmbajtjes dhe/ose problemit). Të menduarit kritik mbart komunikim efektiv si edhe aftësi për zgjidhjen e problemeve, si edhe angazhim për të tejkaluar egocentrizmin dhe sociocentrizmin.

Të menduarit kritik është një aktivitet, që në vetvete, përfshin disidencën. Kjo i vendos individët që praktikojnë mendimin kritik në kundërshtim me anëtarët e tjerë të shoqërisë dhe shpesh me vetë shtetin. Disidenca është një burim i fuqishëm për zhvillimin e arsytimit publik si edhe për të përcaktuar legjitimitetin e veprimeve dhe institucioneve të një shteti si edhe zakonet e praktikat e një shoqërie të caktuar. Në këtë mënyrë disidenca nënkupton mosrënien dakord me çështje, politika dhe praktika specifike në një shoqëri si edhe aftësinë për ta artikuluar këtë mospajtim. Është pikërisht artikulimi i disidencës që e bën atë një çështje politike. E parë në këtë këndvështrim, disidenca është politike në momentin që ajo drejtohet drejt një çështjeje specifike në shoqëri.

Marrëdhënia e disidencës me tolerancën përfshin rolin e minoriteteve në kolektivat më të mëdha të njerëzve, praktikat e të cilave shihen nga shoqëria e gjerë si kundërshtuese të normave të atij kolektivi. Tolerimi i disidencës është një forcë vitale për të zgjeruar qëllimin e përfshirjes dhe pëlqimit brenda një shteti, duke

rritur në këtë mënyrë legjitimitetin e legjislacionit dhe politikave brenda një shteti të caktuar. Nga ana tjetër, kjo mund të jetë edhe një forcë destabilizuese që minon legjitimitetin e shtetit duke i kërkuar këtij të fundit që të sanksionojë praktika që të tjerët mund t'i shohin si të norma bazike dhe universale.

Sipas Joonas Leppänen, disidenca është 'pozitive dhe konstruktive për shumë arsye: ajo kultivon qytetarinë, ajo synon të lëvizë padrejtësitë, dhe mund të përmirësojë strukturën institucionale dhe forcojë pjesëmarrjen në shoqëri' (Leppänen, 2016, p. 18). Qasja këtu është se disidenca duhet të mirëpritet, më tepër se sa të luftohet. Disidenca dhe disidentët duhen parë si njerëz që bëjnë deklaramë të justifikuar dhe për këtë arsye ata duhen pranuar apo dëgjuar. Disidentët shihen si njerëz që janë të aftë të sjellin ide të reja për zhvillimin e shoqërisë demokratike.

Qëndrimet ndaj disidencës dhe disidentëve

Historikisht, qeveritë shtypëse kanë synuar që ta ndëshkojnë disidencën politike. Shtypja e disidencës politike konsiderohet si një përpjekje për të mbytur diskursin publik rreth gënjeshtreve të qeverisë, korrupsionit dhe paaftësisë. Pothuajse çdo kundërvënie ndaj disidencës është e bazuar në termat ideologjike duke theksuar kërcënimin që i kanoset identitetit, vlerave dhe të ardhmes së një shoqërie. Duke qenë se disidenca politike synon të përçojë pakënaqësinë apo pa-pajtueshmërinë me politikat apo trupën qeverisë, shtypja e saj konsiderohet si një përpjekje për të mbytur diskursin politik rreth gënjeshtreve të qeverisë, korrupsionit apo absurditetit (marrëzisë).

Disidenca dhe zhvillimi i demokracisë

Koncepti i disidencës mbart një karakter përshkrues dhe normativ. Vlera e disidencës është e lidhur ngushtë me idenë e të parit të saj si një kontribut pozitiv për shoqërinë. Me fjalë të tjera, vlera e disidencës shtrihet në idenë se kushdo që e shpreh atë është bazuar në një kërkesë për të ndryshuar një politikë apo praktikë të gabuar apo për të ndryshuar *status quonë* e situatave të cilat konsiderohen si shtypëse. Disidenca, si një qasje për të luftuar padrejtësitë është konceptuar nëpërmjet idesë normative të barazisë në pjesëmarrje që do të thotë pjesëmarrjen demokratike. Nëse disidenca është një vlerë që është e orientuar drejt zhdukjes së shtypjes institucionale, ajo do të shihet, gjithashtu, si një mënyrë e justifikuar e

pjesëmarrjes demokratike.

Disidenca është një karakteristikë themelore e shoqërisë demokratike, kjo për faktin se demokracia, në vetvete, mbart pikëpamje të ndryshme. Duke qenë se demokracia është një mënyrë për të menaxhuar apo jetuar me idetë konfliktuese, disidenca bëhet e domosdoshme.

Disidenca në një strukturë demokratike sfidon idenë se demokracia është thjesht një sistem përfaqësimi. Çdo sistem demokratik domosdoshmërisht përfshin përjashtimin. Përjashtimi nënkupton mohimin e zërave të një pjese të qytetarëve/shoqërisë. Kështu, ka gjithmonë zëra të cilët nuk janë përfaqësuar dhe që mbeten të heshtur. Me fjalë të tjera, asnjë sistem demokratik nuk mund të rmbulojë larminë e pikëpamjeve në një shoqëri të caktuar. Disidenca formon një kanal për shprehjen e zërave të heshtur. Në këtë kuptim ajo ka një natyrë gjithëpërfshirëse. Është pikërisht kjo që e lidh konceptin e disidencës me demokracinë pjesëmarrëse. Duke garantuar të drejtën për të bërë disidencë është i mundur zhvillimi i mëtejshëm i demokracisë dhe qytetarisë demokratike në shoqëri. Disidenca nuk duhet parë si patologji për zhvillimin e demokracisë që mund të kërkohej për hir të ruajtjes së stabilitetit por si një karakteristikë qendrore e shoqërisë demokratike dhe jetës politike.

DISIDENCA SI INTERES INDIVIDUAL DHE KOLEKTIV

Disidenca është e lidhur me rregullimin e institucioneve shoqërore. Një shënjestër e mundshme e disidencës janë institucionet shtypëse. Në këtë mënyrë, përveç zhvillimit të mëtejshëm të demokracisë, disidenca synon përmirësimin e strukturës së institucioneve shoqërore.

Nëse ne e shohim sistemin përfaqësues si lehtësuesin kryesor të një shoqërie disidente, atëherë ndryshimi në shoqëri do të ndodhë në përputhje me vullnetin e shumicës. Një të kuptuar i tillë do të shkonte në përputhje me premisën e Leninit se ‘politika fillon atje ku janë masat.’ Ky nocion i politikës e zhvendos vëmendjen e politikës nga individualja drejt përfaqësimit kolektiv të shoqërisë.

Nga ana tjetër, disidenca është një karakteristikë që i përket demokracisë pjesëmarrëse dhe si një rrugë për të marrë pjesë në shoqëri që ka justifikim të fortë demokratik. Për Kantin, disidenca ishte e rëndësishme për të promovuar kapacitetin e individëve për të ekzaminuar jetët e tyre në marrëdhënie me të tjerët apo kapacitetin social për arsyetimin publik. Nëse disidenca shihet kështu, atëherë ndryshimi ka një burim të fortë të minoritetet që janë përjashtuar apo shtypur. Pohimi këtu përfshin apelimin për njohjen e identiteteve të ndryshme. Individët të cilët i përkasin një minoriteti etnik apo kolektivi kulturor, kërkojnë që dallimet e tyre të akomodohen me qëllim që ata të kenë oportunitete të barabarta, për të

ndjekur idealet e tyre për një jetë të mirë.

Si realizohet shtypja e disidencës?

Faktet tregojnë se asnjë formë e shprehjes nuk është luftuar agresivisht më shumë sesa mospajtimi me lidershipin. Ata që janë në pozitat e pushtetit kanë interesa të dukshme në mbytjen e diskursit publik rreth gënjeshtreve të qeverisë, korrupsionit, marrëzisë, dhe shumë prej taktikave që ata përdorin për të futur disidencën në një qark të mbyllur duke shkaktuar në këtë mënyrë censurë.

Shtypje e disidencës i referohet aksionit të ndërmarrë për të ndaluar apo ndëshkuar një person që bën deklaratat publike apo diçka që shihet si një kërcënim për grupet e fuqishme të interesit, të tilla si qeveria, korporatat apo profesionet. Shtypja është një veprim kundër disidencës që nuk përfshin, domosdoshmërisht, dhunën fizike.

Shtypja e disidencës ndodh në disa forma:

Shtypja e drejtpërdrejtë, ndodh në rastet kur një person bën deklaratat publike ose bën diçka që shihet si një kërcënim për interesat e fuqishme të grupit. Zakonisht kjo bëhet nga qeveria, industria ose profesionet, por mund të jenë, p. sh. edhe organizatat fetare apo ato të mjedisit. Për pasojë, veprimet merren si një përpjekje për të ndaluar apo penalizuar personin ose aktivitetin.

Shtypja indirekte, mund të ndodhë për shkak të mënyrës se si grupet e fuqishme të interesit kontrollojnë pjesën më të madhe të institucioneve. Kjo ndodh veçanërisht në punësim dhe edukim. Individët që i shohin idetë e institucionalizuara si jo relevante, krahasuar me idetë e tyre, e shohin veten të shtypur për shkak të mungesës së hapësirës për t'i shprehur pakënaqësitë. Ato mund të përjetojnë shtypje të drejtpërdrejtë nëse përpiqen që të sjellin ndryshimin.

Vetëcensura, ndodh shpesh sepse njerëzit janë të shqetësuar rreth rrezikimit të vendit të punës, perspektivës për të bërë karrierë apo mundësisë për të jetuar pa kërcënime në komunitetet e tyre, ose sepse ata i frikësohen shtypjes së drejtpërdrejtë.

Metodat e përdorura kundër kritikës përfshijnë:

Censura e të shkruarit;

Blllokimi i publikimeve;

Blllokimi i emërimeve;

Blllokimi i promovimeve;

Largimi nga ose mos rikthimi në punë;
Bllokimi ose tërheqja e granteve për punë kërkimore;
Transferim i detyruar në punë;
Qortimet;
Mohimi i të drejtës për të bërë punë kërkimore;
Ndjekje penale;
Izolim;
Eleminim;
Përfshirja në listat e zeza;
Përhapja e thashethemeve.

Çfarë mund të bëhet për të zhvilluar disidencën?

Përdorimi i metodave informale, kjo përfshin bisedat me ata që ushtrojnë shtypje, duke u përpjekur që të zgjidhin mosmarrëveshjet. Një reagim i tillë mund të jetë i suksesshëm në rastet kur shtypësi e kupton se veprimi ka qenë i gabuar apo në rastet kur janë të gatshëm të ndryshojnë.

Përdorimi i kanaleve formale, kjo nënkupton apelimin formal kundrejt vendimeve si p. sh. duke çuar çështjen te Avokati i Popullit apo në Gjykatë Kushtetuese apo hapjen e proceseve ligjore. Disavantazhi i kësaj qasjeje është se institucionet shtetërore apo korporatat kanë avantazh në zotërimin e burimeve, dhe për pasojë shkaktohen vonesa në zgjidhjen e çështjeve në rrugë ligjore.

Forcimi i sindikatave të punëtorëve/profesionistëve ose organizatave të tjera relevante, në rastet kur sindikatat apo stafi i lidhur me to dalin në mbrojtje të një disidenti, kjo mund të jetë shumë efektive. Por, në shumë raste, ata nuk ndërhyjnë apo edhe më keq kalojnë në krahun e shtypësve.

Ngritja e një fushate ndërgjegjësimi, kjo mund të përfshijë shkrimin e artikujve dhe bërjen e tyre pjesë të debateve publike. Është qenësish e rëndësishme që veprimet të merren kundër shtypësve. Kjo për faktin se ndikimi më i rëndësishëm i shtypjes nuk është mbi vetë disidentin (edhe pse ai / ajo vuan pasojat e dhunës) por mbi vëzhguesit të cilët vështrojnë procesin. Çdo rast shtypjeje është një sinjalizim potencial për të mos ju kundërvënë sistemit. Dhe në çdo rast të kundërvënies ndaj shtypjes ka një reagim interesi i të cilit është të tregojë se çdo sulm kundër sistemit nuk do të tolerohet.

PËRFUNDIME

Disidenca nënkupton mosrënien dakord me çështje, politika dhe praktika specifike në një shoqëri si edhe aftësinë për ta artikuluar këtë mospajtim. Është pikërisht artikulimi i disidencës që e bën atë një çështje politike. E parë në këtë këndvështrim, disidenca është politike në momentin që ajo drejtohet drejt një çështjeje specifike në shoqëri.

Disidenca është e lidhur me rregullimin e institucioneve shoqërore, politikave dhe praktikave të ndjekura prej tyre. Një shënjestër e mundshme e disidencës janë institucionet shtypëse. Në këtë mënyrë, përveç zhvillimit të mëtejshëm të demokracisë, disidenca synon përmirësimin e strukturës së institucioneve shoqërore.

Disidenca në një strukturë demokratike sfidon idenë se demokracia është thjesht një sistem përfaqësimi. Disidenca është një karakteristikë që i përket demokracisë pjesëmarrëse dhe si një rrugë për të marrë pjesë në shoqëri që ka justifikim të fortë demokratik.

Ata që janë në pozitat e pushtetit kanë interesa të dukshme në mbyajtjen e diskursit publik rreth gënjeshtrave të qeverisë, korrupsionit, marrëzisë, dhe shumë prej taktikave që ata përdorin për të futur disidencën në një qark të mbyllur duke shkaktuar në këtë mënyrë censurë.

Shoqëria njerëzore mund të përdorë forma të ndryshme për zhvillimin e ruajtjes së disidencës të tilla si: përdorimi i kanaleve formale dhe informale, forcimi i sindikatave të punëtorëve/profesionistëve ose organizatave të tjera relevante si edhe ngritja fushatave të ndërgjegjësimit.

BIBLIOGRAFIA

Bauman, Z. (2015). *Holokausti dhe moderniteti. Pika pa Sipërfaqe. Tiranë*

Bauman, Z. (2017). *Moderniteti i lëngët. Pika pa Sipërfaqe. Tiranë*

Eilerman, D. (2006). *Conflict: Personal dynamics and choice. Retrieved September 17, 2007*

Leppänen, L. 2016. *A Political Theory of Dissent: Dissent at the Core of Radical Democracy. Helsinki. Fq. 18. (Punim për mbrojtje akademike).*

<https://helda.helsinki.fi/bitstream/handle/10138/162600/apolitic.pdf?sequence=1&is-Allowed=y> [Aksesuar më 17/05/2019]

Luhmann, N & Giorgi, De, R. (2016). *Teoria e shoqërisë. Pika pa Sipërfaqe. Tiranë*

MARRËDHËNIET PUBLIKE TË PUNËS: JURIDIKSIONI CIVIL VS. JURIDIKSIONI ADMINISTRATIV

Dr. Gerta MEHMETI

*Kolegji Universitare Pavarësia Vlorë
gerta.mehmeti@unipavaresia.edu.al*

Abstract

Nëpërmjet përcaktimit të kompetencës lëndore të gjykatave, ligji arrin të qartësojë nëse kontrata e punës të nëpunësve civilë që rregullohet nga Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” ndryshon nga ajo e nëpunësve të një organi të administratës publike “pa status” që rregullohet nga dispozitat e Kodit të të Punës, (për të qartësuar më pas çështjen e juridiksionit të cilit duhet t’i nënshtrohen). Në fakt është Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” ndryshuar me Ligjin nr. 39/2017 që qartëson çështjet lidhur me juridiksionin administrativ në marrëdhëniet e punës në shërbimin civil. Në vendimin nr.3 datë 6.12.2013 Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë qartësoi edhe aspekte procedurale lidhur me juridiksionin administrativ vs. civil në lidhje me konfliktet e lindura në marrëdhënien e punës të nëpunësve civilë apo të punonjësve të administratës publike, marrëdhënia juridike e të cilëve me organin punëdhënës rregullohet sipas normave të Kodit të Punës.

Keywords: shërbimi civil, juridiksion administrativ, rekurs administrativ, privatizim i punësimit publik.

Në nivel komunitar në 2003 Traktati i Nisës parashikonte mundësinë e themelimit të gjykatave të specializuara në nivel BE-je dhe Këshilli i Bashkimit Evropian pat vendosur kështu, që të themelojë më 2 nëntor 2004 Gjykatën e Shërbimit Civil Civil Service Tribunal duke i deleguar shqyrtimin dhe gjykimin e çështjeve të punës në shërbimin civil. Kompetencat e saj, të cilat deri në këtë

moment performoheshin nga Gjykata e Përgjithshme e Bashkimit Evropian, do të lidheshin drejtpërdrejtë me zgjidhjen e konflikteve në shkallë të parë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe stafit të këtij të fundit me mundësi apelimi në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë. Kjo formulë qe efektive deri në 2016, kur BE-ja u ndërgjegjësua se aneksimi i çështjeve të shërbimit civil ishte kishte kosto multilaterale.

I ngjashëm me zgjidhjen komunitare profili francez në aspektin e juridiksionit në lidhje me kontratat administrative të punës, dhe krejt origjinal nga ana tjetër sistemi italian i cili me “reformën Madia” të punësimit publik azhornuar me DD.Lgs. 25 maj 2017 në nenet 74 e 75 modifikon më tej D.Lgs. 30-3-2001, nr.165 Testo Unico sul pubblico impiego, i cili konsolidon procesin e ‘privatizimit’ të marrëdhënieve publike të punës, proces ky që me përjashtim të disa rasteve të përcaktuara shprehimisht në ligj, kërkon të përafrojë disiplinën e nëpunësve civilë me atë të punës private, kontraktimit kolektiv dhe rrjedhimisht juridiksionit të gjykatës së zakonshme.

Nisur nga fakti që gjykatat administrative në Shqipëri janë ende “në moshë parashkollore” dhe duke konsideruar se gjyqtarët administrativë sipas nenit 5 pika 2, gërma ç) janë ish-gjyqtarë të zakonshëm me eksperiencë më shumë se 5 vjet, a nuk do të ishte me vend që eksperiencia italiane të na japë indikacione mbi privatizimin e punësimit publik në mënyrë që marrëdhëniet e punësimit të mbeten ekskluzivitet civil?

1. Aspekte juridiksionale në lidhje me kontratat administrative të punës pas Ligjit 49/2012

Në përkufizimin që i bën Ligji 44/2015¹ “Kontrata administrative” është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik. Sipas këtij definicioni kontrata e punës e lidhur ndërmjet një organi të administratës publike dhe nëpunësit civil është një kontratë administrative e identifikuar si e tillë nga ligji procedural.² Duke u përcaktuar shprehimisht në ligj ose në një dispozitë procedurale se gjykimi i mosmarrëveshjeve do ti përkasë kompetencës lëndore të gjykatave administrative, nëpërmjet këtij përcaktimi ligji në fakt, pa u shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë për natyrën juridike të kontratës, e konsideron atë si administrative. Ligji nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative”³,

1 Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 28 maj 2015 dhe ka hyrë në fuqi një vit pas botimit në Fletoren Zyrtare (neni 189).

2 E.Dobjani, *Kontratat Administrative, Traktat teorik dhe praktik i kontratave administrative në të drejtën shqiptare*, EMAL Botim i parë 2017, f. 219.

3 Ligji nr 44/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave admin-

përpara ndryshimeve të vitit 2017⁴, si një ligj kryesisht procedural i nënshtrohet juridiksionit administrativ të gjitha kontratat e punës të agjentëve kontraktorë të administratës publike, të cilët nuk përfitojnë statusin e nëpunësit civil. Këta janë nëpunësit kontraktorë marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet me kontratë pune bazuar në Kodin e Punës. Për këtë kategori ligjvënësi ka përcaktuar shprehimisht në nenin 7 shkronja ç) të Ligjit 44/2012 se “Gjykatat administrative janë kompetente për:... mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike,” dhe në nenin 15 shkronja c) parashikon se “Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: c) punëmarrësi ose punëdhënësi për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike”. Situata u korrigjua më pas me Ligjin 39/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative’” e ndryshon nenin 7, shkronja ç) si më poshtë:

“ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përfshihen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës.”,

e kështu na është e qartë se ndryshimi i natyrës së kontratës së punës me të njëjtin ligj procedural ndryshon edhe juridiksionin së cilit i nënshtrohet kjo e fundit. Por si janë sjellë gjykatat administrative të themeluara me dekretin presidencial nr. 8349⁵ nga nisja e zbatimit të L.44/2012 deri në momentin e ndryshimeve të L.39/2017?

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë u shpreh⁶ në lidhje me juridiksionin në një çështje kundër Bashkisë Vlorë e cila në shkallë të parë⁷ pa përfundimin e shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e zakonshme civile por vendimi përfundimtar u dha një ditë pas formimit të gjykatave administrative në datë 5 nëntor 2013, dhe me anë të këtij të fundit u shpreh moskompetenca lëndore e gjykatës civile duke qenë se një ditë më parë u formuan gjykatat administrative. Në një vendim unifikues Gjykata e Lartë qartësoi këtë inkongruencë në lidhje me çështje të cilat ishin në gjykim në momentin e dekretimit të gjykatave administrative. Në ven-

istrative dhe gjykimine mosmarrëveshjeve administrative”

4 Ligji nr. 39/2017 Për disa shtesa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

5 Sipas Dekretit nr.8349 datë 14.10.2013 “Për fillimin e funksionimit të gjykatave administrative”, funksionimi i gjykatave administrative filloi me 4 nëntor 2013.

6 Vendimi nr. 6936 datë 09.09.2014 Gjykata Administrative e Apelit

7 Vendimi nr. 2439 date 05.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

dimin unifikues nr.3/2013⁸ çështja objekt gjykimi lidhet me zgjidhjen e një mosmarrëveshje administrative, e cila ka filluar të shqyrtohet para datës 04.11.2012, datë në të cilën pas Dekretit të Presidentit të Republikës të nxjerrë në zbatim të nenit 70/5 të Ligjit 49/2012, kanë filluar realisht që të ushtrojnë funksionin e tyre gjykatat administrative. Ligji nr.49/2012 nuk përmban ndonjë dispozitë kalimtare ku të jetë shprehur në lidhje me ligjin e zbatueshëm për mosmarrëveshjet administrative që ishin në gjykim apo gjykimi i të cilave nuk kishte filluar akoma deri me datë 04.11.2013. Në këto kushte, Kolegji Administrativ ka mbajtur parasysh parimin se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të natyrës civile dhe administrative, ndryshe nga ato penale, gjykata nuk mund të refuzojë shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se ligji mungon, prandaj u pa e nevojshme të diskutohej në Kolegje të Bashkuara çështja nëse kompetenca për shqyrtimin e këtij rekursi i përket Kolegjit Administrativ apo Kolegjit Civil, me qëllim dhënien e një interpretimi përfundimtar lidhur me zbatimin e këtij ligji. Kolegji Administrativ, në gjykimin e çështjes konkrete, vlerësoi se interpretimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara i shërben zgjidhjes së problemeve që janë krijuar në praktikë në gjykatat e të gjitha niveleve si dhe zbatimit të ligjit në mënyrë të drejtë e në përputhje me vullnetin e ligjvënësit në gjykimin e çështjeve, për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar para datës 04.11.2013, apo shqyrtimi i të cilave ka filluar para kësaj date dhe ende nuk është dhënë vendim përfundimtar për to.

Në kushtet kur Ligji nr.49/2012 nuk përmbante dispozitë kalimtare ku të përcaktohej se cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013 në gjykatën e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatën e Lartë, ose për mosmarrëveshjet administrative që ishin në shqyrtim para këtyre gjykatave në datën 04.11.2013, pyetja që lind është a duhet të shqyrtohen ose të vijoje gjykimi i këtyre çështjeve nga gjykatat ku ato janë paraqitur para kësaj date apo duhet t'i kalojnë për kompetencë lëndore gjykatës administrative të shkallës së parë, gjykatës së apelit administrativ dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë? Përgjigjen tashmë e kemi marrë nga neni 10 i L.39/2017 por ajo që vërehet është se fryma me të cilën është zgjidhur çështja e mësipërme asokohe është në moskoherencë me zgjidhjen që ka ofruar dhe imponuar ligji procedural i mëvonshëm. Në Vendimin Unifikues nr. 3/2013 Kolegjet e Bashkuara njohën datën 04.11.2013 si ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative, e cila shënoi dhe fillimin e efekteve të plota juridike dhe zbatimin në tërësi të Ligjit nr.49/2012 lidhur me juridiksionin, kompetencën dhe procedurën e gjykimit të çështjeve që kanë për objekt mosmarrëveshjet administrative të përmendura në nenin 7 të L.44/2012. Neni 72, pika 1 dhe 2 i Ligjit nr.49/2012 parashikon se me fillimin e funksionimit të gjykatave administrative, të përcaktuar me Dekretin e Presidentit të Republikës, shfuqizohen normat procedurale mbi kompetencën lëndore dhe tokësore si dhe

normat ekzistuese procedurale të posaçme mbi gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Pas datës 04.11.2013, gjykatat civile kanë apo jo kompetencë lëndore për zgjidhjen e çështjeve administrative që kanë në shqyrtim ose që presin të shqyrtohen apo për të cilat trupi gjykues në përfundim të shqyrtimit gjyqësor është tërhequr për të dhënë vendimin? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë marrë në konsideratë edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese⁹ e cila është shprehur vazhdimisht për kushtetutshmërinë e një procesi duke theksuar se, në të drejtën procedurale ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe duke parashikuar dispozita procedurale kalimtare. Në këto raste, i takon ligjvënësit të shprehet lidhur me efektet në kohë të ligjit procedural. Pra është vetë ligjvënësi i cili duhet të shprehet se nuk do të zbatohet ligji i ri procedural por ai i vjetri, gjë që do të thotë se vetë ligji i ri duhet të ketë të përcaktuar qartë se në lidhje me çfarë problemesh dhe deri në çfarë afati kohor do të vazhdojë të zbatohet ligji i vjetër procedural dhe jo ai që është në fuqi. Po kështu, vetë ligji i ri procedural në mënyrë të shprehur duhet të përcaktojë nëse norma e re procedurale nuk do të zbatohet menjëherë, por në një kohë të ardhme, kohë të cilën vetë ligji duhet ta specifikojë. Nëse kjo ndodh, atëherë, pavarësisht se ligji ka hyrë në fuqi, ai nuk i shtrin efektet menjëherë dhe ndaj çështjeve që janë në gjykim. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në interpretimin unifikues se Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me Ligjin nr.49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma.

Sipas L.39/2017 neni 11 qartëson se çështjet aktualisht në gjykim në Gjykatën e Lartë do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit në fuqi, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji të ri, dhe kemi kështu një anë tjetër të medaljes mjaftueshëm surprizuese e cila ndryshon plotësisht opinionin unifikues të Gjykatës së Lartë mbi sa më sipër. Në nenin 10 të ligjit 39/2017 në korrelacion me nenin 4 të të njëjtit ligj, në të njëjtën frymë të nenit 11 qartësohet se mosmarrëveshjet mbi marrëdhëniet e punës të punonjësve në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës, që ditën e hyrjes në fuqi të ligjit 44/2012 janë në gjykim në gjykatat administrative, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke ndjekur

të njëjtën formulë të ruajtjes së sigurisë juridike në procesin e rregullt gjyqësor dhe këtu norma është shtrëuese dhe nuk ka vend për interpretime të tjera.

2. Nota krahasuese me sistemin ligjor Italian

Disiplina aktuale e nëpunësimit publik në sistemin Italian përmbahet në D.Lgs. 30-3-2001, n. 165, i ashtuquajtur Teksti Unik mbi punësimin publik. Bëhet fjalë për një masë që konsolidoi procesin e privatizimit të punës publike dhe që ka qëllim të arrijë disa objektiva themelore (neni. 1, D.Lgs. 165/2001):

— së pari, rritja e efikasitetit të administratës në relacion me atë të zyrave homologe dhe shërbimeve në vendet Bashkimit Evropian, edhe nëpërmjet zhvillimit të koordinuar të sistemeve informative publike;

— së dyti, racionalizimi i kostos së punës publike, nëpërmjet përfshirjes të shpenjimeve komplekse për personelin, brenda kufijve të financës publike;

— dhe se fundi përmirësimi i burimeve njerëzore, duke u kujdesur edhe për formimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional, duke garantuar shanse të barabarta për punonjëset dhe punonjësit duke aplikuar kushte uniforme me ato të punës private. Nuk ka qenë gjithnjë kështu, për sa kohë në një fazë të parë, raporti i nëpunësimit civil ishte objekt i një disipline rigorozisht unilateral, rregulluar nga akte të natyrës legjislative ose rregulluese (p.sh. ato të nomina me të cilin emëroheshin nëpunësit civilë), në të cilin nuk i njihej asnjë peshë burimit kontraktor dhe disiplinimi i mosmarrëveshjeve të mundshme ishte kompetencë e Giudice Amministrativo.

Hap i parë drejt barazimit ndërmjet punës private dhe asaj publike u hodh me D.P.R. 10-1-

1957, n. 3, që përmbante Testo unico degli impiegati civili dello Stato. Por D.Lgs. 13-2-1993, n. 29 çeli procesin e privatizimit në punësimin publik duke përafruar disiplinën e nëpunësve civilë me ata privatë dhe si rrjedhojë vendosjen nën juridiksionin e gjykatës të zakonshëm civil. Mbi bazën e Ligjit Bassanini n. 59 datë 1997, D.Lgs. 31 mars 1998, n. 80 (e ashtuquajtura seconda privatizzazione) u modifikua impianti i D.Lgs. 29/1993, duke forcuar valencën e kontratës, si individuale dhe kolektive dhe duke zgjeruar hapësirat e “deligjifikimit” dhe autonomisë në organizimin e zyrave.

Proçesi i privatizimit i nisur në vitet '90 ka modifikuar në mënyrë të konsiderueshme fushën e së drejtës së punës italiane duke shkuar përtej profileve ngushtësisht substanciale të disiplinës. Nga kjo në fakt janë verifikuar disa rrjedhoja ndër të cilat edhe devolucionin e mosmarrëveshjeve në fushën e marrëdhënieve të punësimit te gjykatësi i zakonshëm *giudice ordinario*, në funksion të gjykatës të

punës, kompetenca këto të cilat më parë i rezervoheshin juridiksionit ekskluziv të gjykatësit administrativ.

Neni 63 D.Lgs. 165/2001 përcakton kompetencat e gjykatësit të zakonshëm ose administrativ duke i dhënë ekskluzivitet gjykatësit civil (të zakonshëm) «tutte le controversie relative ai rapporti di lavoro alle dipendenze delle pubbliche amministrazioni» me përjashtim të atyre të paprivatizuara. Përfshihen mosmarrëveshjet që lidhen me rekrutimin në punë l'assunzione

al lavoro (me përjashtim të fazave që lidhen me procedurat e konkurrimit), dhënia dhe heqja e funksioneve drejtuese incarichi dirigenziali dhe përgjegjshmëria e nëpunësve që kanë funksione drejtuese si dhe ato që lidhen me të drejta të lindura në përfundim të marrëdhënies së punësimit. Sipas pikës 4 të nenit 63 të këtij D.lgs. mbeten nën juridiksionin e G.A (giudice amministrativo) ...”le controversie in materia di procedure concorsuali per l’assunzione dei dipendenti delle pubbliche amministrazioni, nonché, in sede di giurisdizione esclusiva, le controversie relative ai rapporti di lavoro di cui all’articolo 3, ivi comprese quelle attinenti ai diritti patrimoniali connessi.”, gjyqatrë e zakonshëm, administrativë apo kontabël, avokatët dhe prokurorët e Shtetit, personeli military dhe Forcat e Policisë së Shtetit, presoneli i karrierës diplomatike dhe prefektët, si dhe personeli i entev, aktiviteti i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë. Në konjicion të gjykatësit administrativ si mund të vëmë re lihen vetëm mosmarrëveshjet e fazës që paraprin themelimin e marrëdhënies së punës, pra gjithçka që lidhet me kriteret përzgjedhëse të kandidatëve: nga bando i konkurrimit deri te formacioni përfundimtar dhe graduatoria (lista e fituesve). Kështu pra, deri në aprovimin e graduatoria gjykon G.A.; pas aprovimit gjykon G.O. Gjykatësi administrativ ndërmerr kundrejt administratës publike, të gjitha masat për qartësimin, ose dënimin siç e kërkon natyra e të drejtave të mbrojtura. Vendimet me të cilat njihet e drejta e punësimit, ose që vërtetojnë punësimin në dhunim të normave substanciale dhe procedurale, kanë efekt themelues ose zgjidhës të raportit të punësimit (art. 63, comma 2, D.Lgs. 165/2001).

Pika 2 ashtu si është plotësuar nga D.Lgs. 75/2017, në zbatim të reformës Madia, vijon duke përcaktuar se gjykatësi, me vendimin me të cilin anulon ose deklaron nul pushimin nga puna, dënon administratën me detyrimin për kthimin në vendin e punës dhe pagesën e një shpërblimi për dëmin e shkaktuar në masën e pagës së fundit për llogaritjen e trajtimit nga përfundimi i marrëdhënies së punësimit deri në momentin e rimarrjes në punë, deri në masën 24 paga mujore. Gjithashtu administrata publike njëlloj si punëdhënësi privat, është e detyruar të paguajë gjithë kontributet shoqërore e shëndetësore. Bëhet fjalë për të ashtuquajturën tutela reale nel lavoro pubblico, e paraqitur në korpusin e Testo Unico del pubblico impiego në bazë të kriterëve të L. 124/2015, që kërkonte zgjidhjen e antinomive ndërmjet sektorit publik dhe privat në temën e zgjidhjes së marrëdhënieve të punësimit.

Neni 3/2 Personale in regime di diritto pubblico (D.Lgs 75/2017 na insipiron për të arsyetur në lidhje me regjimin juridiksional për profesorët dhe kërkuesit shkencorë. Sipas parashikimit të dispozitës së përmendur mësipër marrëdhënia e punësimit të profesorëve e kërkuesve shkencorë ricercatori universitari, me kohë të caktuar apo të pacaktuar, rregullohet nga dispozitat në fuqi, në pritje të disiplinës specifike që do të rregullojë në mënyrë organike dhe në përputhje me parimet e autonomisë universitare për të cilën flitet në nenin 33 të Kushtetutës Italiane dhe në ligje të veçanta.

Paqartësia juridike e normës së sipërpërmendur mund të zgjidhet nga qartësia juridike me të cilën përcaktohen ato funksione që konsiderohen se bien nën optikën e personale in regime di diritto pubblico. Në përputhje me këtë normalisht norma na drejton që në pritje të disiplinës specifike për tu miratuar t'i referohemi dispozitave në fuqi të aplikueshme për të punësuar në administratën publike që nuk janë subjekte të së drejtës publike sipas nenit 3 dhe kështu i përkasin juridicionit të zakonshëm civil.

